

URDHËR
Nr. 5, datë 4.1.2023

**PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN NR. 854, DATË 31.12.2021, “PËR DELEGIM
KOMPETENCASH”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të pikës 2, të nenit 73, kreu IX, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 425, datë 27.5.2020, “Për procedurat e përzgjedhjes së subjekteve të pajisura me licencë për projektim, zbatim, mbikëqyrje dhe kolaudim në pasuritë kulturore”, i ndryshuar, dhe të udhëzimit nr. 269, datë 11.8.2020, të ministrit të Kulturës, “Për miratimin e dokumenteve standarde të konkurrimit publik për përzgjedhjen e subjekteve të pajisura me licencë për projektim, zbatim, mbikëqyrje dhe kolaudim në pasuritë kulturore, për kryerjen e investimeve me fonde publike në pasuritë kulturore”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Në pikën 2, të urdhrit nr. 854, datë 31.12.2021, “Për delegim kompetencash”, i ndryshuar, togfjalëshi “*deri më 31.12.2022*” zëvendësohet me togfjalëshin “*deri më 31.12.2023*”.

2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I KULTURËS
Elva Margariti